



# USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 27 (827725)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 2 Korrik 2021

## Gjeneral Bajram Begaj-homologu turk Gjeneral Yaşar Güler



### Gjeneral Begaj dhe Gjeneral Güler, bisedë telefonike mbi zhvillimet aktuale

Sipas Agjensise Turke te lajmeve (AA) të datës 28 qershor 2021, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Turqisë, gjeneral Yaşar Güler, ka zhvilluar një bisedë telefonike me homologun e tij shqiptar, gjeneral Bajram Begaj. Sipas një njoftimi të lëshuar nga Forcat e Armatosura Turke (TSK), në faqen e saj elektronike, Güler

dhe Begaj shkëmbyen mendime mbi zhvillimet aktuale. Më 28 mars 2019, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm FA të Turqisë, Gjeneral Yasar Guler ka zhvilluar vizitë në Shqipëri ku është pritur nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, ku ky i fundit ka falënderuar...

» faqe 2

## PAS DREJTIMIT 2019 DERI 2021

### Shqipëria i dorëzon Bullgarisë kryesimin e iniciativës rajonale SEDM



» faqe 4

## Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI), sot 90 vjet Peleshi: Mbrojtja kibernetike është element kyç përballë kërcënimeve nga fuqi rivale

Mbrojtja kibernetike është pjesë e sigurisë kombëtare. Në bashkëpunim me aleatët amerikanë po ngrihet Njësia e Mbrojtjes Kibernetike » faqe 3



## Takimi Begaj-Takada

### Ekzistojnë mundësi bashkëpunimi dy-palësh në fushën e mbrojtjes

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneralmajor Bajram Begaj, priti më 29 qershor, në një takim kortezie ambasadorin e Japonisë, të akredituar në vendin tonë, sh.t.z. Mitsuyuki Takada. Gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit diskutuan për qasjen e përbashkët që kanë të dy vendet ndaj sfidave të sigurisë duke qenë partnerë në kuadër të aleancave me vlera demokratike...



» faqe 2

## Manovra me qitje në det

### Tetë anije zhvillojnë stërvitjen detare dy ditore "GRUPEX 21"

Efektivë të Flotiljes Detare, në zbatim të planit vjetor të aktiviteteve të Forcës Detare, në datat 22 dhe 23 qershor 2021, zhvilluan stërvitjen "GRUPEX 21" dhe qitjet bregdetare. Në stërvitje morën pjesë tetë anije: gjashtë anije ishin nga Grupi i Parë i Anijeve Patrulluese, përkatësisht anijet "Oriku" P-132, "Butrinti" P-134, "Shiroka" P-117, "Skënderbeu" P-112...

» faqe 4

## SIGURINË E KOSOVËS

### Ish-gjenerali Clark mund të bëhet këshilltar në Ministrinë e Mbrojtjes

» faqe 11

## MINISTRI I MBROJTJES NIKO PELESHI

### "Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të lartë dhe komisioneve të zakonshme të karrierës"

» faqe 3

## FSK-BMR

### Nisma "Lundro dhe Pastro" për një mjedis të pastër në Liqenin e Kukësit

» faqe 5





## Gjeneral Bajram Begaj-homologu turk Gjeneral Yaşar Güler

Gjeneral Begaj dhe Gjeneral Güler,  
bisedë telefonike mbi zhvillimet aktuale

*Që nga viti 1998, janë firmosur dhe ratifikuar 26 marrëveshje ushtarake, grante dhe protokolle me Qeverinë e Republikës së Turqisë. Turqia*

Sipas Agjensise Turke të lajmeve (AA) të datës 28 qershor 2021, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Turqisë, gjeneral Yaşar Güler, ka zhvilluar një bisedë telefonike me homologun e tij shqiptar, gjeneral Bajram Begaj. Sipas një njoftimi të lëshuar nga Forcat e Armatosura Turke (TSK), në faqen e saj elektronike, Güler dhe Begaj shkëmbyen mendime mbi zhvillimet aktuale.

Më 28 mars 2019, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm FA të Turqisë, Gjeneral Yasar Guler ka zhvilluar vizitë në Shqipëri ku është pritur nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, ku ky i fundit ka falënderuar Gjeneral Guler për mbështetjen e gjithanshme të FA turke për transformimin dhe modernizimin e Forcave tona të Armatosura në fusha të ndryshme, si arsimimi, stërvitja, logjistika, etj. Të dy ushtarakët e lartë vlerësuan gjithashtu angazhimet e përbashkëta në kuadër të NATO në Afganistan, si dhe shprehën bindjen se ky bashkëpunim do të vijojë edhe në të ardhmen, jo vetëm si dy vende dhe popuj miq, por edhe si anëtarë të Aleancës Euroatlantike. Kurse, në datat 20 dhe 21 qershor 2019, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, ka zhvilluar një vizitë zyrtare dy ditore në Turqi me ftesë të homologut turk Güler.

Që nga viti 1998, janë firmosur dhe ratifikuar 26 marrëveshje ushtarake, grante dhe protokolle me Qeverinë e Republikës së Turqisë. Turqia. Ky partner strategjik i vendit tonë, e ka mbështetur në mënyrë të vazhdueshme Shqipërinë në fusha të ndryshme, përfshirë dhe logjistikën ushtarake në përputhje me programin për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare të vendit tone.

Ndër marrëveshjet më të fundit është ajo e datës 24 mars 2021, lidhur me bashkëpunimin në fushën e Mjekësisë Ushtarake, ku pala turke merr përsipër kurimin falas në institucionet mjekësore ushtarake të anëtarëve aktivë në detyrë të Forcave të Armatosura dhe familjarëve të tyre, personelit në rezervë dhe pension të Forcave të Armatosura dhe personelit civil që punon në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Marrëveshja rregullon trajtimin e studentëve ushtarakë shqiptarë, të cilët studiojnë për mjekësi në Turqi, me bursa falas, si dhe parashikon kurse dhe specializime për rritjen e tyre profesionale.



SHEFI I SHPFA PRITI AMBASADORIN E JAPONISË, MITSUYUKI TAKADA

Ekzistojnë mundësi bashkëpunimi  
dy-palësh në fushën e mbrojtjes

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, priti më 29 qershor, në një takim kortezie ambasadorin e Japonisë, të akredituar në vendin tonë, sh.t.z. Mitsuyuki Takada.

Gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit diskutuan për qasjen e përbashkët që kanë të dy vendet ndaj sfidave të sigurisë duke qenë partnerë në kuadër të aleancave me vlera demokratike përdimore, si dhe ndanë të njëjtat mendime lidhur me kërcënimet dhe rreziqet e reja me të cilat përballen vendet dhe rolin që duhet të kenë Forcat e Armatosura për përballimin e tyre.

SHSHPFA, gjeneralmajor Begaj e falenderoi ambasadorin Takada për përpjekjet e tij në forcimin e lidhjeve midis dy vendeve, si dhe vlerësoi kontributin e Japonisë me projekte rindërtimi në operacionet e drejtuara nga aleanca e NATO, veçanërisht në Afganistan. Ambasadori



i Japonisë vlerësoi rolin e Shqipërisë në sigurinë e rajonit dhe më gjerë, duke nënvizuar mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen.

Në përfundim të takimit gjeneralmaj-

jor Begaj pasi i uroi ambasadorit Takada suksese në detyrën e tij, e siguroi atë mbi gatishmërinë e FARSH për të eksploruar mundësitë e bashkëpunimit dy-palësh në fushën e mbrojtjes, kryesisht në përbal-

limin e emergjencave civile. Z. Takada mori detyrën e ambasadorit të Japonisë në Shqipëri në muajin nëntor 2020 dhe është ambasadori i dytë pas hapjes së Ambasadës së Japonisë në janar 2017.



## Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI), sot 90 vjet

# Peleshi: Mbrojtja kibernetike është element kyç përballë kërcënimeve nga fuqi rivale

*Mbrojtja kibernetike është pjesë e sigurisë kombëtare. Në bashkëpunim me aleatët amerikanë po ngrihet Njësia e Mbrojtjes Kibernetike*

Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit (ASNI), pjesë e rëndësishme e Forcave të Armatosura të Shqipërisë kremtoi ditën e mërkurë, më 30 qershor 2021, 90-Vjetorin e Krijimit të Shërbimit të Ndërlidhjes. Pjesë e ceremonisë së organizuar me këtë rast ishin edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Përgjithshëm i Shtabit të FA gjeneralmajor Bajram Begaj, zëvendësmministria Dallëndyshe Bici si dhe ish-ushtarakë, ish-punonjës të ASNI.

Në fjalën përshëndetëse, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vuri në dukje se kjo agjenci është një arterie dhe komponent shumë i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm i gjithë përpjekjes që FA bëjnë për të mbajtur me nder edhe me dinjitet pozicionin që u takon si pjesë e NATO. Duke vlerësuar punën dhe arritjet e kësaj strukture në 90 vite të funksionimit të saj, ministri i Mbrojtjes foli për sfidat që e presin në të ardhmen.

“Sot platformat e komunikimit janë rritur shumë, trafiku i komunikimit dhe i ndërlidhjes është shuar së tepërmi, çka do të thotë se edhe ekspozimi ndaj kërcënimeve është rritur shumë. Mbrojtja kibernetike, natyrisht sot është pjesë e sigurisë kombëtare dhe është kthyer në një fjalë kyçe në të gjitha, diskutimet, komunikimet, platformat, politikat e NATO-s dhe aleatëve tanë. Rajoni ynë dhe bashkë me të edhe Shqipëria natyrisht nuk bën dallim, jemi pjesë e globit, por natyrisht jetojmë edhe në një rajon, i cili ka pranë kërcënime edhe nga fuqi rivale, të cilat veç të tjerash dhe më së shumti përdorin komunikimin e ndërlidhjen, botën kibernetike si një armë për të penetruar dhe për të rritur influencën e tyre”, - theksoi ministri Peleshi.

Z. Peleshi theksoi faktin se tashmë teknologjia, inovacioni, ndërlidhja, komunikimi, teknologjitë e informacionit



janë kthyer në një prioritet të Ministrisë së Mbrojtjes. Për t’iu përgjigjur sfidave të kohës, z. Peleshi tha se në bashkëpunim me aleatët amerikanë po ngrihet Njësia e Mbrojtjes Kibernetike. Duke premtuar edhe përmirësim të sistemit të motivimit që nga pagat, shpërblimet apo edhe kualifikimet ai u shpreh: “Ju keni bërë një punë të shkëlqyer ndër vite dhe tani keni strukturë të re, e cila do t’i shërbejë organizimit të punës dhe rritjes së efikasitetit të performancës suaj, por nga ana tjetër ne do të bëjmë më të mirën edhe për sistemet e tjera të motivimit, nga pagat-shpërblimet edhe deri te

hapësirat e kualifikimit, e rikualifikimit, hapësirat e riprodhimit të sa më shumë kapaciteteve njerëzore, të cilat mund të jenë në dispozicionin tuaj. E kam fjalën kryesisht për Akademinë e Forcave të Armatosura, ku këtë vit të ri akademik ne do të hapin dy-tre programe të reja, dy programe në ‘bachelor’, një prej tyre është Teknologji Informacioni në fushën e Mbrojtjes, tjetra është Komandim Detar në fushën e Mbrojtjes, si dhe një ‘master’ në Siguri Kibernetike”.

Zanafilla e krijimit të kësaj agjencie daton më 30 qershor 1931 me



krijimin e dy kompanive të ndërlidhjes dhe një kompani telegrafiste. Pas gjithë këtyre viteve shërbim ndërlidhje, sot ASNI është në gjendje të sigurojë dhe të mbështesë me sisteme komunikimi dhe informacioni për realizimin e

komandim-kontrollit të FA në nivel strategjik dhe operacional në të gjitha kohërat si dhe të shkëmbejë informacion me NATO-n, të trajnojnë dhe të stërvisin personelin e shërbimit të ndërlidhjes në FA.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Urdhër nr.886, datë 28.6.2021

## "Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të lartë dhe komisioneve të zakonshme të karrierës"

Në mbështetje të pikës 4, të nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të pikës 2, të shkronjes “f”, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, të pikës 7, të nenit 22, të ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e komisionit të lartë dhe komisioneve të zakonshme të karrierës”, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij urdhri.

Përgjigjet për zbatimin e këtij urdhri: komisionet e karrierës, komandantët e forcave, komandanti i Komandës Mbështetëse, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, komandantët e njësive dhe repartave të varësisë së drejtperdrejtë të MM dhe SHPPA, Drejtoria e Mirëad-



*Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes Nr.239, datë 20.2.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të lartë dhe komisioneve të zakonshme të karrierës”, shfuqizohet.*

ministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Qendra e Personel Rekrutimit, Drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.

Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes Nr.239, datë 20.2.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin

dhe funksionimin e komisionit të lartë dhe komisioneve të zakonshme të karrierës”, shfuqizohet.

Ndjekin zbatimin e këtij urdhri sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

## VENDIMI I KESHILLIT TË MINISTRAVE



## Përcaktimi i specialiteteve në Forcat e Armatosura

Këshilli i Ministrave në mbledhjen e ditës së mërkurë, datë 30 qershor 2021, ka miratuar propozimin e ardhur nga Ministria e Mbrojtjes lidhur me specialitetet në Forcat e Armatosura. Kështu Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin “Për përcaktimin e specialiteteve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Vendimi i mesipërm është mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/1, të nenit 21, të ligjit nr.59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Kështu Këshilli i Ministrave vendosi përcaktimin e specialiteteve në Forcat e Armatosura, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij vendimi. Kurse ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.



# Pas drejtimimit 2019 deri 2021

## Shqipëria i dorëzon Bullgarisë kryesimin e iniciativës rajonale SEDM

*Iniciativa Rajonale e SEDM e themeluar në vitin 1996 në Tiranë, me pjesëmarrjen e gjithë vendeve të Europës Juglindore, është një proces integrimi dhe bashkëpunimi në fushat e sigurisë dhe të mbrojtjes rajonale*

Mbi bazën e rotacionit, që nga 1 korriku 2021, Ministria e Mbrojtjes e Bullgarisë do të jetë kryetare e Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore (SEDM Process). Shqipëria i ka dorëzuar Bullgarisë stafetën për drejtimin e Iniciativës Rajonale të Southeastern Europe Defence Ministerial (SEDM), pas një periudhe të suksesshme që ajo mbajti kryesimin nga viti 2019 deri në 2021. Për këtë, Sekretariati i SEDM-Ç/PMSC mori pjesë në Takimin Koordinues që u zhvillua në datat 15-18 qershor 2021, në Sofje, Bullgari. Bisedimet janë përqendruar mbi thellimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe në vështirësitë e mbajtjes së takimeve të rregullta me prani për shkak të pandemisë.

Delegacioni i Sekretariatit të SEDM-Ç/PMSC kryesohej nga z. Gjergji Methoxha, drejtor i Drejtorisë së Politikave të NATO-s dhe BE-së dhe njëkohsisht drejtor i Sekretariatit të SEDM.

Takimi midis dy Delegacioneve u fokusua në anën procedurale të përgatitjes dhe zhvillimit të takimeve të Komitetit Koordinues (SEDM-Ç) dhe Komitetit Drejtues Politiko-Ushtarak (PMSC), mbi punën dhe arritjet e Sekretariatit të SEDM gjatë periudhës 2019-2021 si dhe mbi dorëzimin e arkivit të SEDM dhe materialeve të tjera në kuadër të kësaj Iniciative.

Ceremonia zyrtare për dorëzimin dhe marrjen e kryesimit të Sekretari-



atit të SEDM nga Bullgaria, u zhvillua më datë 26 gusht 2021, në Kumanovë, Maqedoni e Veriut (vendi ku është dislokuar Brigada e SEEBRIG), periudhë e cila përkon edhe me 22-Vjetorin e SEEBRIG HQ.

Në kuadër të kësaj vizite zyrtare, në datën 15 qershor 2021, Delegacioni

i Sekretariatit SEDM-Ç/PMSC, vizitoi dhe SEEBRIG HQ në Kampin "Boro Menkov" në Kumanovë, Maqedonia e Veriut.

Gjatë kësaj vizite, Sekretariati i SEDM pati një takim me komandantin e SEEBRIG HQ, gjeneral brigade Aristeidis Iliopoulos. Drejtori i Sek-

retariatit, nënvizoi faktin se SEEBRIG është një histori suksesi, pasi është një nga nismat e para dhe të rëndësishme, që janë ndërmarrë në rajonin tonë dhe ka kontribuar shumë në sigurinë dhe stabilitetin rajonal, në besimin reciprok dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë midis vendeve të Europës

Juglindore.

Iniciativa Rajonale e SEDM e themeluar në vitin 1996 në Tiranë, me pjesëmarrjen e gjithë vendeve të Europës Juglindore dhe SHBA-së, paraqet tashmë një proces të integrimit dhe të bashkëpunimit në fushat e sigurisë dhe të mbrojtjes rajonale.



### Forcat e Armatosura: Kampionati i Futbollit për vitin 2021

## Forca Tokësore fiton Kampionatin e Futbollit në rang FA

Në mjediset e Garnizonit "Skënderbej", në Ministrinë e Mbrojtjes, u zhvillua më 28 qershor 2021, ceremonia e mbylljes së Kampionatit të Futbollit për Forcat e Armatosura për vitin 2021, ku morën pjesë tetë ekipe, përfaqësuese të komandave të forcave kryesore dhe reparteve autonome (FT, FD, FAJ, KM, PU, AFA, ASNI, BMB-SHPFA).

Kampionati i futbollit është një aktivitet sportiv i përvitshëm, i cili përveç rëndësisë që ka në përgatitjen fizike të trupave, përcjell dhe mesazhin "Miqësi nëpërmjet Sportit" (Friendship through Sport). Në këtë kampionat ekipet u ndanë në dy grupe dhe ekipet e renditura në vendet e para dhe të dyta u kualifikuan në fazën finale. Finalja e kompeticionit, e cila u ndoq nga afër nga zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji, si dhe drejtorë drejtorish në SHP, u luajt ndërmjet Policisë Ushtarake dhe Forcës Tokësore, ku Forca Tokësore fitoi me meritë me rezultatin 1-0 dhe u shpall "Kampion" i Kampionatit të Futbollit në FA-së, për vitin 2021.



Në përshëndetjen e saj drejtuar pjesëmarrësve në këtë aktivitet sportiv, gjeneralmajor Shehu vuri theksin se këto aktivitete i shërbejnë rritjes së frymës së kolektivitetit dhe shpirtit të garës, tipare këto që karakterizojnë Forcat e Armatosura, për arritjen e synimeve dhe objektivave për realizimin e detyrave. Më tej, zëvendëshefi i SHP të FA-së përshëndeti në veçanti fituesit e këtij kompeticioni, por edhe sportistët e përzgjedhur për krijimin e ekipit përfaqësues në FA, në kompeticionet e ardhshme brenda dhe jashtë vendit. "Ky aktivitet tregon më

së miri se sporti i shërben forcimit të miqësisë midis ushtarakëve, rritjes së ndjenjës së bashkëpunimit dhe respektit ndaj njëri – tjetrit, por edhe më gjerë. Futboli është lojë që harmonizon më së miri përfitimin e cilësive të forcës, rezistencës shpejtësisë si dhe aftësive që ushtaraku duhet të zotërojë për përballimin e stresit mendor dhe emocional në stërvitje, detyrë, operacion", u shpreh ndër të tjera gjeneralmajor Shehu.

Vendin e parë në kampionatin e futbollit të FARSH për vitin 2021 e fitoi ekipi i komandës së Forcës Tokësore, ndërsa vendin e dytë e zuri Policia Ushtarake si dhe dy vendet e treta Forca Detare dhe Komanda Mbështetëse. Ndeshjet në grup: Ndeshja e parë Forca Tokësore-Forca Detare 1:1. Ndeshja e dytë Forca Tokësore-Forca Ajrore 5:0. Ndeshja e tretë Forca Tokësore-Policia Ushtarake 1:0. Gjysmë finale: Forca Tokësore-Forca Detare 3:0. Finale Forca Tokësore-Policia Ushtarake 1:0. Në këtë aktivitet sportiv u shpërndanë certifikata dhe medalje për arbitrat dhe asistentët që drejtuan ndeshjet e futbollit midis ekipeve pjesëmarrëse, si dhe medalje për lojtarët dhe ekipet fituese pjesëmarrës në këtë kampionat.

### VIZITA

## Shoqata e Ushtarakëve Rezervë vizitë te ushtarakët e Kosovës

Në kuadër të vizitës në Kosovë dhe aktiviteteve me shoqatën homologe kosovare, delegacioni i nivelit më të lartë, i Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes ku u pritën nga zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Syla. Me këtë rast, kolonel Thoma Konduri, i shoqëruar nga major Hamit Gojani dhe major Kujtim Boriçi si dhe kryesuesi i shoqatës së oficerëve rezervë të Kosovës, CIOR Kosova, nënkolonel Prindon Sadriu, dhe kolegu kapiten Gezim Kunoviku, shprehu përshtypjet e tij për pritjen vëllazërore duke njoftuar në vazhdim me fushëprimin, aktivitetet e organizatës dhe qëllimin e vizitës në funksion të thellimit të bashkëpunimit dhe koordinimit me kolegët e Kosovës për të ardhmen. Nga ana e tij, zv. ministri Syla falënderoi për vizitën duke përgëzuar për iniciativën shumë domethënëse dhe me interes në diplomacinë tonë të mbrojtjes, duke pasur parasysh statusin e Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve Rezervë të Shqipërisë si anëtare e Konfederatës Ndërlidhëse të Oficerëve Rezervë (Interallied Confederation of Reserve Officers- CIOR), asociacion ky i shoqatave të oficerëve rezervë në NATO dhe më gjerë, ku aspiron edhe shoqata e oficerëve rezervë të Kosovës, CIOR Kosova. Në fund, nënkolonel Sadriu njoftoi me aktivitetet e CIOR Kosova, dhe bashkëpunimin me shoqatën homologe të Shqipërisë, që pritet të kurorëzohet së shpejti me zyrtarizmin e marrëveshjes bilaterale. Ai gjithashtu, njoftoi se CIOR Kosova angazhohet për afirmimin e ushtarakut rezervë të Kosovës edhe në rrafshin ndërkombëtar shumë të nevojshëm në këtë periudhë të zhvillimeve të përgjithshme.





FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS (FSK)-BATALIONI I MBËSHETJES RAJONALE (BMR)

## Nisma "Lundro dhe Pastro" për një mjedis të pastër në Liqenin e Kukësit

*U realizua pastrimi i një vije prej 7 km në bregun e liqenit të Kukësit, duke i shërbyer vendit e turizmit. Nga KM u angazhuan 2 varka, 4 mjete dhe 47 forca të BMR dhe DMR Kukës*

Në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) e vullnetarë të tjerë, Batalioni i Mbështetjes Rajonale (BMR) të Komandës Mbështetëse (KM), ka marrë pjesë më 26 qershor, në një operacion të veçantë, atë të pastrimit të bregut të liqenit të Kukësit nga mbetjet plastike dhe ato inerte.

Në ceremoninë e hapjes për këtë qëllim ishin të pranishëm Ministri i Turizmit dhe Mjedisit Blendi Klosi, zëvendësministria e Mbrojtjes Dallëndyshe Bici, shefi i Operacioneve të KM kolonel Ernest Premçe, ndërsa nga pala kosovare ishin të pranishëm ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj, zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FSK-së dhe ambasadori i Shqipërisë në Kosovë Minxhozi.

Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj theksoi se me këtë aksion, dëshmojmë se vullneti ynë është vullnet për të pastrën, të bukurën, të natyrshmen që i duhet jo vetëm popullit tonë në dy shtetet, por të gjithë popujve dhe të gjithë njerëzimit. Gjithashtu, ai tha se "ushtria përveç se është gjithmonë e

gatshme të përballet me kërcënime dhe rreziqe të karakterit ushtarak, ajo është e gatshme dhe çdo çast në veprim për të parandaluar dhe evituar fatkeqësitë dhe katastrofat natyrore dhe ato të shkaktuara nga faktori njeri". Aksioni u realizua me sukses dhe nga të gjithë pjesëmarrësit u vlerësua se duhet që programe të ngjashme të organizohen edhe në të ardhmen.

Nëpërmjet këtij operacioni u realizua pastrimi i një vije prej 7 km, të bregut të liqenit të Kukësit, pranë vijës kufitare Shqipëri-Kosovë nga papastërtitë e mbetjet inerte, duke i shërbyer vendit e turizmit. Nga KM u angazhuan 2 varka, 4 mjete dhe 47 forca të BMR dhe DMR Kukës.

Kryeministri Rama e ka përshëndetur nismën "Lundro dhe Pastro" si një nismë që u vendos "në jetë", nga autoritetet shqiptare dhe ato në Kosovë. Kryeministri Rama, nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale, shkruan se Kosova dhe Shqipëria janë një komb, një destinacion dhe kanë një qëllim: Për të pasur një mjedis e turizëm të përbashkët në të dyja anët e Bjeshkëve. Kjo nismë konsiston në mbajtjen pastër të mjedisit, për t'i ofruar kështu turistëve dhe



pushuesve një pamje më të plotë e të pastër të bukurive të të dyja vendeve. "Jena 1. Një komb, një destinacion, një ofertë turistike dhe një mjedis i pastër. Forcat e ushtrisë së Shqipërisë e Kosovës së bashku me vullnetarë, në një ditë pastrimi të tokës e ujërave të përbashkët, për të vijuar me bashkëpunime të tjera në mjedis e turizëm në të dyja anët e Bjeshkëve", -shkruan kryeministri.

## Manovra me qitje në det, në Sazan dhe Karaburun

# Tetë anije zhvillojnë stërvitjen detare dy ditore "GRUPEX 21"

*Në stërvitje morën pjesë tetë anije: gjashtë anije ishin nga Grupi i Parë i Anijeve Patrulluese, përkatësisht anijet "Oriku" P-132, "Butrinti" P-134, "Shiroka" P-117, "Skënderbeu" P-112, "Mati" P0-2 dhe "Shkumbini" P-03; dy anije ishin të Grupit të Dytë të Anijeve Patrulluese, përkatësisht "Iliria P-131" dhe "Lissus P-133"*

Efektivë të Flotiljes Detare, në zbatim të planit vjetor të aktiviteteve të Forcës Detare, në datat 22 dhe 23 qershor 2021, zhvilluan stërvitjen "GRUPEX 21" dhe qitjet bregdetare. Në stërvitje morën pjesë tetë anije: gjashtë anije ishin nga Grupi i Parë i Anijeve Patrulluese, përkatësisht anijet "Oriku" P-132, "Butrinti" P-134, "Shiroka" P-117, "Skënderbeu" P-112, "Mati" P0-2 dhe "Shkumbini" P-03; dy anije ishin të Grupit të Dytë të Anijeve Patrulluese, përkatësisht "Iliria P-131" dhe "Lissus P-133". Në stërvitje gjithashtu mori pjesë edhe Grupi i Bordingut.

Stërvitja GRUPEX u zhvillua nga Komanda e Flotiljes Detare kryesisht për certifikimin e kapaciteteve të grupeve patrulluese. Gjatë stërvitjes "GRUPEX 21" u përpunuan elementët e manovrimit taktik, operacioneve të embargos detare (MIO), operacioneve të kërkim-shpëtimit (SAR) dhe elementë të stërvitjes së furnizimit në det (RAS).

Stërvitja "GRUPEX 21" dhe qitjet bregdetare ishin të ndërthurura me njëra-tjetrën si pjesë e një skenari të përgatitur nga Shtabi i Flotiljes Detare në përputhje me qëllimin e operacioneve të sigurisë detare në detin Adriatik dhe Jon. Stërvitja GRUPEX dhe qitjet bregdetare shërbyen për kompaktësimin e veprimeve të anijeve të Flotiljes Detare në nivel grupi. Qitjet bregdetare u zhvilluan në ishullin e Sazanit, me armatimin e anijeve në poligonin e vetullores në pjesën perëndimore të Karaburunit. Efektivët artiljer/mitraljer dhe oficerët e rinj të anijeve zhvilluan qitje sipas kushteve të ushtrimeve.

Stërvitja GRUPEX dhe qitjet bregdetare u ndoqën nga komandanti i Forcës Detare, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, shefi i Shtabit të Forcës Detare, komandanti i Flotiljes Detare dhe përfaqësues të shtabit të Forcës Detare, të cilët ishin të imbarkuar në bord të anijes Butrinti për gjatë dy ditëve. Stërvitja "GRUPEX 21" dhe qitjet bregdetare u zhvilluan dhe përfunduan me sukses.

Stërvitja "GRUPEX 21" është përshëndetur edhe nga ministri i Mbrojtjes Niko Perleshi, nëpërmjet facebook-ut. "8 anije me efektivë të Forcës Detare për dy ditë me rradhë zhvilluan stërvitjen "GRUPEX 21" si dhe qitje bregdetare. Edhe një herë efektivët tanë treguan profesionalizmin e tyre në element manovrimi taktik, operacioneve të kërkim-shpëtimit, operacioneve të embargos apo edhe elementëve të stërvitjes së furnizimit në det", shkruan Peleshi në facebook.



GARNIZONI I FLOTILJES DETARE PASHALIMAN

## Përfundon stërvitja fushore-ujore "Pashalimani 21"

Nga data 20-25 qershor, Batalioni i Forcave Speciale u dislokua në garnizonin e Flotiljes Detare Pashaliman, ku ka zhvilluar stërvitjen fushore-ujore "Pashalimani 21". Qëllimi i kësaj stërvitje ishte rritja e kushteve fizike të personelit, përvetësimi i teknikave të notimit, i teknikave për kalimin e pengesave ujore, si dhe aftësimi i përdorimit të mjeteve lundruese me dhe pa motor në interes të përballimit të emergjencave civile. Hapjen e kësaj stërvitjeje e ndoqi nga afër komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale kolonel Arben Zani, i cili përgëzoi efektivët e këtij batalioni për punën dhe përkushtimin e treguar gjatë kësaj stërvitjeje. Stërvitja "Pashalimani 21" është një nga stërvitjet fushore-ujore, e cila vijon të kryhet dhe nga repartet e tjera të Forcës Tokësore.







PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

### Shqiptarët krijuan mitin me prejardhje krenarie

Krijimi i kombit shqiptar është bazuar tek etniciteti si gjaku, gjuha, shtrirja gjeografike etj., të cilët ka qenë të vetmit element unifikues. Nacionalizmi shqiptar, nuk i pati bazat e veta tek parimet liberale apo bashkimet kulturore, si në disa vende të tjera, por për shkak të izolimit nga gjithëpërfshirja në mendimin evropian si pasojë e dominimit të konservatorëve, të cilët e penguan zhvillimin e nacionalizmit. Shqiptarët kishin një mitologji kombëtare që krijuan mitin e një prejardhjeje krenarie të lashtë për vendin dhe shtetin.

Dashuria për Atdheun ka qenë gjithmonë një ndjenjë e shëndetshme natyrale, e cila me pak përkujdesje kultivohet lehtë. Kurse prirja e kundërt, mosdashuria për Atdheun është rrjedhojë e disa faktorëve. Injoranca e thellë ku ngeli për shumë shekuj populli ynë, mungesa e shkollave, e universiteteve, e akademive dhe e të gjithë institucioneve kulturore, si dhe mungesa e strukturave shtetërore, e zbehën shqiptarizmin dhe në rastin më të mirë e lanë në një nivel primitiv, që me mjaft vështirësi e kapërceu folklorizmin. Në të tilla kushte, përballja me një kulturë të huaj ka qenë tronditëse për shqiptarët. Kjo kulturë pati këto rrjedhime: së pari i ka shtyrë shqiptarët që në shembëllimin e saj të ringjallnin kulturën e vendit dhe së dyti ti largonte përfundimisht prej Atdheut. Në prag të çlirimit të Shqipërisë i kemi patur të dy prirjet atdhedashurinë dhe shqiptarizmin e mjaft shqiptarëve dhe kundërshqiptarizmin e disa të tjerëve.

Natyrë unike e gjuhës shqipe përbënte një bazë për mitin kombëtar. Periudha e Skënderbeut 1443-1468, përfaqëson të parën shprehje të nacionalizmit shqiptar, i cili u venit pas pushtimit osman dhe u ringjall në vitin 1878, pas Kongresit të Berlinit që vendosi lënien e disa trojeve shqiptare jashtë Perandorisë Otomane për tu bërë qejfin Malit të Zi, Serbisë dhe Bullgarisë.

### Toleranca e popullit

Në shek. XIX Rilindja Kombëtare shënoi konsolidimin e mendimit nacionalist shqiptar. Shqipëria në atë kohë ishte e ndarë në katër vilajete Kosovë, Shkodër, Manastir dhe Janinë. Ndërsa shoqëria shqiptare ishte e ndarë në dy grupime kulturore, gegë dhe toskë. Në Shqipëri bashkëjetonin katër besime fetare, myslimanë, bektashinj, ortodoksë dhe katolikë. Toleranca e gjerë e popullit e shoqëruar me tolerancën fetare, të vërtetuar gjatë shekujve, nuk u vu në dukje e nuk u çmua asnjëherë sa e si duhet. Kjo tolerancë ishte e nevojshme, për të mos thënë e detyrueshme të çmohej. Kjo tolerancë ishte një shembull i shkëlqyer ballkanik. Në këtë kohë gadishulli i madh ishte përfshirë tej e mbanë nga furtunat shoviniste, nga intoleranca e urrëjtja etnike e nga krimet e rënda të ushqyera dhe të nxitura prej tyre. Duhet theksuar se kjo nuk ishte një dukuri e rrallë. Në shumicën e vendeve, ashtu siç ka një përqindje të popullsisë me prirje kriminale, ka edhe një përqindje me prirje të mbrapshtë kundër Atdheut të vet. Kjo ishte e njohur që nga kohërat antike, kur midis grekëve të vjetër gjendeshin

# Rilindasit duhen lexuar e rilexuar gjithmonë



gjithmonë njerëz e prijës që bashkoheshin me armiq të Greqisë. Kjo prirje erdhi deri në kohën tonë, ku grupime të ndryshme politike, sidomos ato ekstremiste, terroriste, maoiste etj., ku cilësi të parë kanë urrëjtjen kundër vendit të tyre, si dhe nënshtrimin me forcë të kundërshtarëve të tyre. Shqetësimi i rilindasve lidhur me këtë çështje të madhe tregon se prirja kundërshqiptare e një pjese të shqiptarëve ishte një rrezik i ndjeshëm për Shqipërinë. Dhe dihet se një prirje e mbrapshtë nuk mund të mbetet gjallë për një kohë të gjatë, pa u ushqyer.

Fatkeqësitë e kaluara të popullit shqiptar, pushtimi osman në shek. XV, copëtimi i Shqipërisë në fillim të shek. XX dhe izolimi i saj nga bota për faj të diktaturës komuniste në gjysmën e dytë të shek. XX nuk krijuan tek shqiptarët as doktrina shfarosëse, as urrëjtje kundër të tjerëve. Këto janë cilësi të admirueshme të tyre. Ka qenë një ndër gurët themelore të qytetërimit shqiptar, nderimi dhe mbrojtja e tjetrit, e atij që është i ardhur,

Italisë, nuk u prekën aspak prej tyre, përkundrazi u morën nën mbrojtje. Nga ana tjetër, është fakt i njohur tashmë që Shqipëria ishte një nga vendet e rralla në botë, në mos i vetmi, që nuk dorëzoi asnjë hebre tek nazistët. Diktatura komuniste me politikën e saj veçuese u mundua ta armiqësonte popullin shqiptar me gjithë botën, kryesisht me botën perëndimore, por nuk ia doli dot. Pas rënies së saj, populli shqiptar dëshmoi ndaj të huajve evropianë dhe amerikanë po atë ndjenjë miqësore të dikurshme.

### Rizgjimi i Atdhedashurisë

Rilindasit duhen lexuar e rilexuar gjithmonë, sidomos në kohëra të vështira. Duke i shfletuar tani, shikojmë se përveç shqetësimit të tyre themelor: çlirimit të Shqipërisë dhe pavarësisë së saj, ishte një ankhë tjetër, i vazhdueshëm, i lidhur ngushtë me të parin: rizgjinin e Atdhedashurisë. Lidhja e Prizrenit, e cila pasoi Kongresin e Berlinit, shënon

Këmbëngulja e tyre për këtë rizgjim, thirrjet e zjarra "Ti Shqipëri më jep nder, më jep emrin shqipëtar" dëshmojnë një të vërtetë tepër të qartë dhe dëshpëruese. Një pjesë e shqiptarëve ishin ftohur prej Atdheut të tyre. Turqizimi i qindra-mijëra shqiptarëve, greqizimi i një pjesë tjetër, ngatërrimi i përkatësisë shqiptare me atë fetare, dëshmojnë se ndjenja patriotike e një pjese të shqiptarëve ka qenë jo aq e fortë si paraqitej. Një pjesë e tyre me lehtësi ishin gati ta këmbenin Atdheun e tyre me një Atdhe tjetër, një pjesë kishin turp të quheshin shqiptarë, të tjerë me lehtësi viheshin në shërbim të forcave kundërshqiptare.

Rilindasit u përpoqën shumë ti bindnin shqiptarët se nuk duhet të turpëroheshin nga vendi i tyre. Ata kishin një Atdhe të bukur, kishin një gjuhë madhështore, një prej 6 gjuhëve themelore të Europës dhe një nga 10-12 gjuhët themelore të Botës. Ata ishin racë e bukur trupërisht dhe tepër të aftë mendërisht, se kishin një histori të shkëlqyer, se gjëmat kombëtare nuk ishin

Në të vërtetë ishte Rilindja Shqiptare që Rilindi Shqipërinë, ose me saktë, ishte ajo që lindi Shqipërinë moderne.

Që kjo lëvizje e ky vrull të ishin të suksesshëm, rilindasit e himnizuan dhe e sublimuan historinë e shqiptarëve. Rilindasit qëmtuan në kulmet e ndritura, duke mos ndalur në njollat e saj. Me këmbëngulje ata nxorrën në pah vlerat morale e fizike të shqiptarëve, kryesisht virtytet pa dashur të ndalen në cenet e tyre, që për hir të së vërtetës, nuk ishin më të pakta se virtytet. Kjo ishte rrjedhojë llogjike e qëllimit të lëvizjes: rifitimit të besimit të humbur. Një arsye tjetër që e përligjte vizionin e tyre pozitiv ishte propaganda kundërshqiptare, që kishte nisur ndërkaq të kultivohej nga fqinjët e Shqipërisë, kryesisht nga rrethet shoviniste serbe dhe greke. Ishte një propagandë e egër dhe shtazarake që rrallë herë ishte parë në fytyrën e dheut. Përballë kësaj furtune të sëmurë, rilindasit shqiptarë mbajtën një qëndrim fisnik e të admirueshëm. Në vend që të binin në nivelin e saj, duke u përdhosur dhe vetë nga balta e kundërshtarëve, ata zgjodhën përgjigjen e tërthortë, lartësimin e vlerave shqiptare. Ky vizion optimist i rilindasve, i përfaqësuar në radhë të parë prej Naim Frashërit e me vonë prej At Gjergj Fishtës, u bë objekt vërejtjesh e kritikash më pas e vazhdon ende sot, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Ringritja morale e popullit shqiptar ishte aksioni më i ngutshëm dhe më i rëndësishëm në atë kohë të vështirë. Ai ishte çelësi, pa të cilin nuk mund të ndërmerret asnjë veprim tjetër shpëtues. A ishin shqiptarët patriotë më shumë se ç'duhet, apo përkundrazi ishin ftohur me vendin e vet? A mos po e mbiçmonin pa të drejtë veten dhe vendin e tyre, a mos përkundrazi e përçmonin pa të drejtë veten dhe Atdheun. Me fjalë të tjera, a e donin këtë vend që u ka dhënë emrin qysh prej dymijë vjetësh, apo ëndërronin ta këmbenin me një tjetër vend. Ëndërr e mbrapshtë kjo që ka ngritur krye aty-këtu e herë pas herë në kohën tonë! E pra në këtë mijëvjeçar të tretë shqiptarët janë të detyruar të nxjerrin ende mësim nga drama e tyre, që ndodhet ende në zhvillim.



i huaj, mik ose bujtës. Kjo ka qenë një mendësi që vjen qysh nga kohët antike. Dhe ky nderim nuk është shpikje poetësh, e as një cilësi e elitës shqiptare, por u vërtetua gjatë Luftës së Dytë Botërore. Dhjetra mijëra italianë të mbetur në Shqipëri në mëshirën e popullsisë së armatosur shqiptare, pas kapitullimit të

përpjekjen e parë për institucionalizimin e nacionalizmit dhe njëkohësisht të kombit shqiptar. Kërkesat e saj ishin bashkimi i trojeve shqiptare në një territor të vetëm me autonomi të plotë nën Perandorinë Osmane. Kështu lindi nocioni i Shqipërisë Etnike, ku për herë të parë shqiptarët do shprehnin aspiratat e tyre kombëtare.

një arsye për t'u ftohur me Atdheun, por përkundrazi, për t'u afruar më fort me të. Aksioni i tyre për zgjimin e Shqipërisë ishte më i madh dhe më i gjëri aksion kulturor në krejt historinë tonë shqiptare. Rrallë herë emërtimi i një lëvizje përkonte plotësisht me qëllimin e saj, ashtu si në rastin e Rilindjes Shqiptare.



# Qendra e Personel Rekrutimit

## Akademia e Forcave të Armatosura: 50 të drejta studimi për vitin akademik 2021-2022

*Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021*

**Q**endra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2021-2022, për 50 (pesëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimiti universitar i përafrohet si vijon: Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike, IT, Telekomunikacion, Inxhinieri Informatike, Kompjuterike), Logjistike (Fakulteti Ekonomik), Xhenio/Infrastrukturë (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Forcë Ajrore (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatikë dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakultetet e tjera). Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021.

### Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Aplikanti duhet të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata; të mos ketë probleme me deportimin; të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale; në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (1 gusht 2022). Përfundim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (1 gusht 2022); të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së; të plotësojë kushtin e sigurisë; të zotërojë diplomën e arsimit të lartë, (minimumi bechelori) të kryer brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jo më pak se 6 (gjashtë); të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatoke, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjisllacionit në fuqi. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e FA-së (nga radhët e ushtarëve dhe nënofficerëve) përveç kriterëve të cituara më sipër duhet: të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”; të




mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

### Procedurat e aplikimit

Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët ia adresojnë Qendrës së Personel Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në aneksin A. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e ushtarëve/detarëve apo nënofficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t'ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës lëshojnë një rekomandim për pjesëmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

### Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve brenda vendit, duhet të paraqesin dokumen-



tacionin e mëposhtëm: a) Në fazën e regjistrimit: kërkesë me shkrim; formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksin A; fotokopje e kartës së identitetit; fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve;

fotografi për dokument (4x6), 2 copë; formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit; raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar

### Datat e testimit:

Datat e testimit për aplikantët janë përcaktuar si vijon: testi i gjuhës së huaj (anglisht) është më datë 10.08.2021, testi fizik është më datë 11.08.2021, testi intelektual është më datë 12.08.2021 dhe testi psikologjik është më datë 12.08.2021.

**Shenim:** Aplikanti deklaron dhe firmos se të dhënat e paraqitura në formularët përkatës janë të vërteta dhe ai autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre nga subjekti i autorizuar. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pas sjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.





## Takimi ministror i Koalicionit Global në Romë

MSC. MIMOZA GOLIKJA

*Mehaj: “Gjeneral Clark më bëri nder të veçantë në jetë dhe në karrierën time duke shprehur vullnetin e tij të plotë për këshillim nga eksperiencia e tij ushtarake dhe diplomatike”*

**S**igurinë e Kosovës dhe të popullit të saj dëshiron ta ketë sërish shqetësim të tij ish-gjenerali amerikan që udhëhoqi kampanjën e bombardimeve të NATO-s në luftën e Kosovës, Wesley Clark.

Ai ia ka shprehur vullnetin e tij ministrit të Mbrojtjes, Armend Mehaj, për t’u angazhuar si këshilltar, si dhe për të ndarë eksperiencën e tij ushtarake dhe diplomatike.

Këtë ofertë të Clark e konsideroi nder të veçantë ministri Mehaj, i cili i bëri ftesë për vizitë në Kosovë dhe që kërkesa e tij u pranua me kënaqësi.

“Gjeneral Clark më bëri nder të veçantë në jetë dhe karrierën time duke shprehur vullnetin e tij të plotë për këshillim nga eksperiencia e tij ushtarake dhe diplomatike, si dhe autoriteti i tij i jashtëzakonshëm në qendrat e vendimmarrjes botërore. Ai shprehu gatishmërinë e tij të plotë të mbështesë me këshillimin e tij në realizimin e qëllimeve të mia strategjike dhe objektive të mi operacional për zhvillimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së”, -ka thënë Mehaj.



Ministri Mehaj dhe gjeneral Rama takohen me gjeneral Tod D. Wolters

## Kapacitetet operationale të FSK-së, sipas standardeve të NATO-s

**M**e ftesë të Komandantit të KFOR-it, gjeneral major Franco Federici, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama u takuan në Shtabin e Përgjithshëm të KFOR-it me komandantin suprem të Forcave Aleate të NATO-s në Europë (SACEUR), gjeneral Tod D. Wolters. Me këtë rast, Ministri Mehaj falënderoi gjeneralin Wolters për angazhimin e trupave të NATO-s në kuadër të misionit të KFOR-it në funksion të sigurisë së përgjithshme në Kosovë dhe mbështetjen e vazhdueshme në zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës. Për më tepër, Ministri Mehaj shprehu vlerësimin e tij për kontributin dhe angazhimin e Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT) në

zhvillimin dhe përparimin e FSK-së në të gjitha aspektet. Gjithashtu, ministri Mehaj, informoi gjeneralin Wolters për arritjet e përgjithshme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, qëllimet dhe objektivat e tij, si dhe shkallën e ndërtimit të aftësive dhe kapacitetet operationale në përputhje me planin e tranzicionit të FSK-së. Ai gjithashtu shprehu mirënjohjen e thellë për mundësinë e dhënë që FSK-ja të marrë pjesë së bashku me forcat amerikane në

operationet e stabilitetit jashtë vendit si dhe pjesëmarrjen në stërvitjen “Defender-Europe 21” me vullnetin që angazhimi i FSK-së në operatione të ngjashme të rritet edhe më shumë për ta bërë edhe më të madh kontributin në ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe sigurisë së përgjithshme në të gjithë botën. Nga ana e tij, gjeneral Rama, e informoi gjeneralin Wolters për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve operationale të FSK-së, sipas standardeve të NATO-s, në mënyrë që të jetë e ndërveprueshme me forcat e vendeve anëtare të NATO-s. Gjenerali Wolters shprehu vlerësimin për arritjet e deritanishme të FSK-së dhe kontributin e saj në sigurinë dhe stabilitetin e përgjithshëm. Ndër të tjera, Gjenerali Wolters përsëriti angazhimin e NATO-s për paqe, siguri dhe stabilitet në Kosovë dhe rajon.



Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim (QNTKSH)

## Qendra për Kërkim-Shpëtim është e rëndësishme për rajonin

**N**ë kuadër të vizitave nëpër njësitë dhe qendrat arsimore dhe profesionale të FSK-së, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, i shoqëruar nga zv. ministri i Mbrojtjes Shemsi Sylja, vizitoi Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit për Kërkim-Shpëtim (QNTKSH) në Pomazatin. Në fillim ai, u prit nga komandanti i Gardës Kombëtare të FSK-së, gjeneral brigade Xhevahir Geci, për t’u takuar më pas me Drejtorin e QNTKSH-së, John Doone, i cili e njoftoi me historikun, misionin, strukturën organizative, fushëveprimin, të arriturat e deritanishme, personelin, pajisjet, infrastrukturën, ambientet trajnuese, aktivitetet aktuale, sfidat dhe projektet për të ardhmen.


Nga ana e tij, ministri Mehaj, pas njoftimit nga afër me informacionet e përgjithshme dhe inspektimit të stacioneve trajnuese, vlerësoi lart punën e QNTKSH-së duke përgëzuar për leadershipin dhe sukseset të gjithë stafin e qendrës, e veçanërisht ish-ushtarakun me përvojë të gjatë të forcave britanike, drejtorin John Doone, duke i siguruar për mbështetje të plotë nga autoriteti i tij. Ai theksoi se kjo Qendër është aset i rëndësishëm, jo vetëm i FSK-së dhe institucioneve tjera vendore por një mundësi shumë e mirë për forcimin e bashkëpunimit bilateral dhe multilateral me ofrimin e aftësive dhe kapaciteteve tona profesionale për trajnime specialistike për operatione të kërkim-shpëtimin të pjesëtarëve nga forcat dhe institucionet tjera të sigurisë së vendeve të rajonit dhe më gjerë. Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim (QNTKSH) në Pomazatin vepron pranë SHP të FSK-së, e cila ka filluar punën në vitin 2016, dhe trajnon jo vetëm personelin e FSK-së, por edhe personelin e institucioneve tjera të sigurisë, si dhe OJQ të vendit tonë. Gjithashtu, në këtë qendër, deri më tash, nga fusha e kërkim-shpëtimin janë trajnuar edhe pjesëtarë nga Shqipëria, Bullgaria dhe Maqedonia Veriore.

Akademia Ushtarake Kroate dhe Universiteti i Zagrebit

## Programi katër vjeçar, Kadeti Valdet Hasani u diplomua në Kroaci

**P**as studimeve në programin katër vjeçar, kadeti Valdet Hasani u diplomua me sukses të lartë në Akademinë Ushtarake Kroatë dhe Universitetin e Zagrebit në Kroaci, në drejtimin “Menaxhment dhe leadership ushtarak”. Suksesi i kadet Hasanit, është suksesi i radhës së kadetëve, ushtarëve, nënofficerëve dhe oficerëve të FSK-së, në akademitë, qendrat profesionale dhe poligonet ushtarake të vendeve partnere, të cilët po prezantojnë vendin, kombin dhe FSK-në në mënyrën më të mirë duke dëshmuar të ardhmen tonë të sigurt. Pas diplomimit, kadet Hasani do t’i bashkëngjitet radhëve të oficerëve të rinj të FSK-së dhe kolegëve të tjerë për të zbatuar njohuritë dhe përvojën profesionale të fituar në detyrat dhe përgjegjësitë ushtarake në FSK.





“Nga një vend që ka dashur të bëhet një anëtar i NATO-s për tre dekada, ne tani jemi pjesë e Aleancës me një kontribut aktiv në sigurinë rajonale. Me rritjen e vazhdueshme të buxhetit të mbrojtjes, ne po investojmë në modernizimin dhe rritjen e kapaciteteve të Armatës me vëmendje të veçantë për transparencën e procesit. Maqedonia e Veriut do të vazhdojë të kontribuojë në misionet dhe operacionet e Aleancës, veçanërisht forcën e KFOR-it në Kosovë dhe misionin në Irak, ku po bëhen përgatitjet për të dërguar një kontingjent nga Ministria dhe Armata”.



Komandanti i Komandës së Lartë Aleate të NATO-s për Europën, Gjeneral Todd Walters

# Kontributi i Maqedonisë së Veriut në NATO është jetik

*Maqedonia e Veriut do të vazhdojë të kontribuojë në misionet dhe operacionet e Aleancës, veçanërisht të KFOR-it në Kosovë dhe misionin në Irak*

Komandanti i Komandës së Lartë Aleate të NATO-s për Europën, Gjeneral Todd Walters, gjatë vizitës së tij të parë zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, arriti më 23 qershor 2021, në Shtabin e Përgjithshëm të Armatës dhe Ministrisë së mbrojtjes. Ai është një nga dy komandantët strategjikë të NATO-s në komandën e operacioneve të Komandës Aleate (ACO). Gjenerali Todd Walters ka qenë në detyrë që nga maji i vitit 2019. Ai është gjithashtu komandant i forcave amerikane në Europë. Pas këndimit të himneve të NATO-s dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe pritjes me nderime të larta ushtarake nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjenerali Walters, pati takime me Ministren e mbrojtjes Radmilla Shekerinska dhe me gjeneralin Gjurginovski. Ministria Shekerinska në takimin me autoritetin e lartë ushtarak të Aleancës, Gjeneralin Walters, duke e përshëndetur dhe falënderuar për nderin e dhënë, tha se Maqedonia e Veriut si anëtare më e re e NATO-s është përqendruar në detyrimet që vijnë nga anëtarësimi i saj, të përkushtuar ndaj vlerave dhe parimeve të Aleancës dhe kontribuon në mënyrë aktive në sigurinë rajonale dhe forcon unitetin e NATO-s.

“Nga një vend që ka dashur të bëhet një anëtar i NATO-s për tre dekada, ne tani jemi pjesë e Aleancës me një kontribut aktiv në sigurinë rajonale. Me rritjen e va-



zhdueshme të buxhetit të mbrojtjes, ne po investojmë në modernizimin dhe rritjen e kapaciteteve të Armatës me vëmendje të veçantë për transparencën e procesit. Maqedonia e Veriut do të vazhdojë të kontribuojë në misionet dhe operacionet e Aleancës, veçanërisht forcën e KFOR-it në Kosovë dhe misionin në Irak, ku po bëhen përgatitjet për të dërguar një

kontingjent nga Ministria dhe Armata. Kontributi i vazhdueshëm afatgjatë në forcën ISAF dhe më pas në Misionin “Mbështetje e vendosur” në Afganistan, i cili sipas vendimit të NATO-s është në fazën e përfundimit, është provë e rolit aktiv të Armatës së Maqedonisë së Veriut në operacionet e Aleancës,” -tha ajo.

Pjesëmarrja e anëtarëve të Armatës

së Maqedonisë së Veriut në misionet e NATO-s vitin e kaluar, por edhe shumë vite para anëtarësimit në NATO u vlerësua si një kontribut i jashtëzakonshëm në Aleancë me rezultatet më të larta.

“Hyrja e Maqedonisë së Veriut në NATO vitin e kaluar është një sukses i vërtetë rajonal. “Kontributi juaj ushtarak në Komandën e Operacioneve Aleate është jetik për paqen dhe stabilitetin e Ballkanit Perëndimor dhe sigurinë e Europës,” -tha Gjenerali Walters në një takim me Ministren Shekerinska.

Rëndësia e lidhjes strategjike midis NATO dhe BE u diskutua në takim, si një proces në të cilin Maqedonia e Veriut si një anëtare evropiane e NATO-s mund të kontribuojë, veçanërisht duke pasur parasysh forcimin e suksesshëm të marrëdhënieve të mbrojtjes me aleatët evropianë në vitin e fundit.

Ata gjithashtu biseduan për rëndësinë e zhvillimit të “Krivolak” si një kapacitet

kombëtar dhe i NATO-s dhe suksesin e stërvitjes më të madhe të NATO-s “Defender Europe 21”, e cila ishte një pjesë integrale e stërvitjes “Goditja vendimtare 21” e “Krivolak”.

Gjatë takimit midis gjeneralëve Gjurginovski dhe Walters, u diskutua për proceset aktuale që ndodhin në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut për integrim të plotë në NATO, siç janë procesi i transformimit të komandave dhe njësive të Armatës dhe niveli i qëllimeve dhe aftësive të arritura si dhe aktivitetet të përbashkëta që përfshijnë anëtarët e Armatës në stërvitjet ndërkombëtare dhe operacionet paqeruajtëse të drejtuara nga NATO. Si pjesë e programit për vizitë, në kazermën “Ilinden” para mysafirit të lartë u kryen ushtrime demonstruese nga pjesëtarët e Armatës. Disa njësi demonstruan trajnim në aktivitetet specifike duke zbatuar standarde dhe procedura në operacionet e NATO-s.

Projekti i NATO-s “Shkenca për paqen dhe sigurinë”

## Uniformë ushtarake shumëfunksionale, kundër zjarrit dhe gazit nervor

Ministria e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut, Radmilla Shekerinska dhe profesori i Fakultetit Tekniko-Metalurgjik pranë Universitetit Shtetëror “Shën Kirili dhe Metodi”, Igor Jordanov, kumtuan një lajm të mirë në lidhje me mbrojtjen, ekonominë dhe shkencën. Në fakt, programi i NATO-s “Shkenca për paqen dhe sigurinë” vendosi të vazhdojë me projektin për zhvillimin e uniformës ushtarake shumëfunksionale me teknologji të lartë me veti speciale për nevojat e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Projekti ka të bëjë me zhvillimin e uniformës ushtarake shumëfunksionale e cila do të jenë rezistente ndaj zjarrit, do të mbrojnë nga mikroorganizmat dhe nga rrezet UV, ndërsa me anë të ndërimit të ngjyrës së saj do të detektojë edhe gazin nervor.

Ministria Shekerinska theksoi se me këtë projekt dëshmojmë se kontributi ynë në kuadër të Armatës nuk është vetëm ushtarak, por edhe shkencor. “Sot po dëshmojmë se vendi ynë nuk kontribuon vetëm në rrafshin ushtarak në kuadër të NATO-s, por se mund të kontribuojë edhe si inovatore



dhe me njerëzit në vendin tonë, si njerëz të shkencës dhe me këtë të dëshmojmë se shteti ka çfarë të ofrojë në këtë rrafsh. Inovojmë dhe mbështesim inovacione të

cilat do të bëjnë Armatën më të mirë dhe më të fortë”, -tha ministria Shekerinska. Shekerinska tha se kjo është një mundësi edhe për inovatorët dhe shkencëtarët e


rinj, por edhe mundësi për ekonominë tonë dhe shtoi se Ministria e Mbrojtjes dhe Qeveria gjithmonë do të mbështesin projektet të cilat janë të dobishme për shtetin. “Me mjetet e projektit të NATO-s do të mund të angazhohim kuadro të reja plotësuese, do të mund të angazhohim edhe shkencëtarë aktual dhe t'i japim mundësi edhe Armatës të ketë prodhime të mira, por gjithashtu edhe ekonomisë së Maqedonisë të ketë mundësi të reja për përfitim. E gjithë kjo, shpresoj se do të jetë një mesazh i duhur deri te komuniteti ynë akademik në mënyrë që ai të jetë me sa më tepër iniciativa dhe ta ketë të qartë se gjithmonë do ta ketë mbështetjen e shtetit, të Qeverisë dhe të Ministrisë së Mbrojtjes”, -tha ministria.

Profesori Jordanov tha se në kuadër të projektit i cili realizohet së bashku

apo në bashkëpunim me Fakultetin Teknologjik-Metalurgjik të Serbisë dhe me Universitetin A&M në Teksas të SHBA-së, mundësi për zhvillim në fushën e ljerjeve do të kenë edhe shkencëtarë të rinj nga vendi ynë, ndërsa fakulteti në Shkup do të fitojë laboratore për materiale të avancuara.

“Përgjatë këtij projekti të paktën dy hulumtues të rinj nga Republika e Maqedonisë së Veriut, do të edukohen në fushën e nano-ljerjeve dhe në fushën e deponimit të nano-grimcave. Fakulteti Teknologjik-Metalurgjik në Shkup do të ketë edhe laborator për materiale të avancuara në vlerë prej rreth 90.000 euro, e që do të jetë një ndër të paktët që gjenden në Europën Juglindore”, -tha profesori dhe shtoi se me punën e përbashkët të ekipeve do të krijohet teknologji e cila do të jetë mjaft e rëndësishme për vendin tonë dhe për komunitetin shkencor në përgjithësi. Shekerinska dhe Jordanov i inkurajuan inovatorët dhe shkencëtarët që të jenë aktiv dhe të aplikojnë me projektet e tyre në thirrjet e programit të NATO-s “Shkenca për paqen dhe sigurinë”, sepse kjo është në dobi të shkencës, por edhe të mbrojtjes dhe ekonomisë së vendit tonë.





Kontingjenti ushtarak bullgar i 42-të mori pjesë në misionin e NATO-s për trajnimin, këshillimin dhe ndihmën e “Mbështetjes së Vendosur” në Afganistan nga marsi deri në qershor 2021. Kontingjenti ka një strukturë të elementit kombëtar, një kompani sigurie dhe oficerë të shtabit.



Misioni “Mbështetje Vendimtare”

# Ushtria bullgare mbaron misionin në Afganistan

*Më 14 prill, aleatët në Aleancë vendosën të tërhiqen nga Afganistani pas një misioni 29-vjeçar*

Kontingjenti i fundit bullgar, i cili merrte pjesë në misionin e NATO-s “Mbështetje Vendimtare”, u kthye nga Afganistani. Që nga marsi i vitit 2021, kontingjenti i 42-të ushtarak bullgar me 120 veta ruante bazën e Aeroportit Bagram në Kabul. Më 24 qershor të kthyerit u nënshtrohen ekzaminimeve mjekësore. Kështu, Bullgaria përfundoi pjesëmarrjen e saj ushtarake në misionin ndërkombëtar të NATO-s për përgatitje, këshillim dhe ndihmë në Afganistan. Më 14 prill aleatët në Aleancë vendosën të tërhiqen nga Afganistani pas një misioni 29-vjeçar.

“Mirë se vini në atdheun tuaj! Shpreh mirënjohjen time të përzemërt në emër të udhëheqjes së lartë ushtarake dhe politike të Ministrisë së Mbrojtjes për përfundimin me sukses të detyrave. Ju përfaqësuat denjësisht Ushtrinë Bullgare në Republikën Islamike të Afganistanit”, -tha Komandanti i Komandës së Forcave të Përbashkëta, gjeneralletjënant Lyubcho Todorov. Në Aeroportin e Sofjes, ata u përshëndetën nga Kalcho Atanasov, kreu i kabinetit politik të Ministrit të Mbrojtjes dhe Gjeneral Brigadës së 61-të të Mekanizuar të Stryama. Kontingjenti ushtarak bullgar i 42-të mori pjesë në misionin e NATO-s për trajnimin, këshillimin dhe



ndihmën e “Mbështetjes së Vendosur” në Afganistan nga marsi deri në qershor 2021. Kontingjenti ka një strukturë të elementit kombëtar, një kompani sigurie dhe oficerë të shtabit. Ai përfshin deri në 120 ushtarakë që kryenin detyrat e tyre në

Kabul dhe në bazën e Aeroportit Bagram. Detyrat kryesore të kontingjentit kishin të bënin me sigurinë gjatë gjithë ditës të një pjese të perimetrit të brendshëm të bazës së aeroportit Bagram, si dhe me kryerjen e ndërrimeve ditore gjatë gjithë

ditës në qendrën e komandës dhe operacioneve të bazës. Elementi kombëtar ushtronte komandën e drejtpërdrejtë të të gjithë kontingjentit ushtarak bullgar dhe kontrollonte respektimin e rreptë të rendit të brendshëm dhe procedurave

standarde operacionale në kryerjen e detyrave të caktuara. Për më tepër, ai siguroi mbështetje logjistike dhe komunikuese për kontingjentin. Komandanti kombëtar i kontingjentit të 42-të ishte kolonel Pavlin Velkov. Me kthimin e kontingjentit të 42-të ushtarak, ka përfunduar pjesëmarrja e formacioneve të Forcave të Armatosura të Republikës së Bullgarisë në Misionin Ndërkombëtar të NATO-s për Përgatitjen, Këshillimin dhe Ndihmën në Afganistan. Vendimi u mor më 15 prill të këtij viti në një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit të Ministrave, në kontekstin e vendimit të Aleatëve për tërheqjen graduale nga 1 maji 2021 e kontingjentëve në misionin “Mbështetje Vendimtare”. Ai u miratua në takimin e jashtëzakonshëm të Ministrave të Punëve të Jashtme dhe Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, më 14 prill 2021.

Piloti Valentin Terziev humbi jetën më 9 qershor

## Hulumtim mbi “kutinë e zezë” të avionit MiG 29

Regjistruesi i parametrave të fluturimit ose e ashtuquajtura “kutia e zezë” e avionit luftarak MiG-29, ku humbi jetën në një stërvitje luftarake, piloti i forcave ajrore bullgare, majori Valentin Terziev, piloti bullgar i avionit luftarak MiG-29, ruhet në kushte të përshtatshme dhe është nën juridiksionin e komisionit të specializuar që po heton çështjen. Kjo u njoftua më 25 qershor, nga komandanti i bazës së tretë ajrore në Graf Ignatievo, gjeneral brigade Nikolay Rusev, në një konferencë për gazetarët. Ai së bashku me nënkolonel Lyudmil Valkov-Shef i Departamentit të Pajisjeve dhe Armatimeve të Aviacionit dhe Major Nikolay Mateev-Inxhinier i Lartë në të njëjtin departament, treguan shembull nga regjistruesi i të dhënave të fluturimit në “kutinë e zezë”.

“Qëllimi i regjistrimit nga “kutia e zezë” është se aty ruhet informacioni nga një numër i madh i sensorëve në bordin e avionit. Pas çdo fluturimi, të dhënat nga regjistruesi shkarkohen dhe përpunohen me softuer të specializuar. Qëllimi është të kemi informacion se si kanë funksionuar sistemet në bord

të avionit për të vendosur nëse janë gati avionët për fluturimin tjetër. Në një rast si ai me rrëzimin e avionit, regjistruesi është krijuar për të siguruar hetuesit me informacionin e nevojshëm për të vlerësuar nëse ka pasur një problem gjatë fluturimit në bord, apo ndonjë situatë tjetër të pafat,” -shpjegoi Nënkolonel Ljudmil Valkov. Ai theksoi se “regjistruesi nuk regjistron komunikime zanore, por parametra që karakterizojnë funksionimin e sistemeve të avionit gjatë fluturimit. Nuk ka sinjale të dukshme në të - dritë, sinjal radio ose zë, të cilat lejojnë që të kërkohet nën ujë me hidraulik”.

Inxhinierët aeronautikë specifikuan se regjistruesi i avionit të rrëzuar arriti në bazën ajrore vetëm me modulën e sigurisë me kujtesën, nga e cila u shkëput blloku që siguron ndërfaqen. Në të dy bordet, të cilat janë të mbushura me material mbrojtës izolues, ka një shkelje të pjesshme të vulosjes dhe dëmtimit të pjesëve të tyre. Lidhësja e kabllos

së ndërfaqes së të dhënave nuk është e arritshme nga pjesa e jashtme e tabelave të qarkut të shtypur. Lidhësja elektrike në anën tjetër të kabllos së shiritit është prishur (mungon). Prishja e pjesshme e vulës ka çuar në hyrjen e ujit dhe mbetjeve të një produkti që konsiderohet të jetë vajguri.

“Unë mendoj se askush nuk dyshon se ne jemi njerëzit që duan më shumë të shkarkojnë informacionin dhe të bëjnë analizën e nevojshme. Fatkeqësisht, ne jemi inxhinierë dhe duhet të jemi realistë se sa shtrihen aftësitë tona,” -tha Nënkolonel Valkov, duke shtuar se shqetësimet e inxhinierëve aeronautikë kishin të bënin me faktin se ato mund të krijonin kushte për humbjen e informacionit. Prandaj, qëllimi i tyre kryesor gjatë punës në hapjen e regjistruesit ishte të mbanin pajisjen në gjendjen në të cilën e morën atë, d.m.th. të mos krijohen parakushte shtesë për humbjen e informacionit. I gjithë procesi u regjistrua në video, iu

dha autoriteteve hetuese. “Kishte shumë njerëz që ishin dëshmitarë të gjykimit dhe unë besoj se bëmë gjithçka që ishte e mundur për ta mbajtur modulën e kujtesës në gjendjen në të cilën na erdhi,” -tha Nënkolonel Valkov. Regjistruesi iu dorëzua komisionit të caktuar nga Ministri i Mbrojtjes për të hetuar rrëzimin e avionit me numrin 39.

Për të mos krijuar kushte për humbjen e informacionit dhe në përputhje me dokumentet që rregullojnë hetimin e incidenteve dhe aksidenteve të tilla, inxhinierët aeronautikë kanë rekomanduar që komisioni të kontaktojë prodhuesin e pajisjes. “Prodhuesi ka krijuar këtë pajisje, ka krijuar pajisje dhe një procesor që kontrollon regjistrimin dhe shkarkimin e informacionit, dhe ai vetëm, dhe në masën më të madhe, mund të garantojë që ky informacion do të shkarkohet pa humbje, -tha Nënkolonel Valkov.

Kur u pyet për prodhuesin e pajisjes, gjeneral brigade Rusev shpjegoi se regjistruesi të tillë u morën në Bazën Ajrore Graf Ignatievo në 2016 nën një kontratë me Ukrainën dhe në 2019 - me kontratat më të fundit me RSK-MiG për furnizimin e pjesëve të këmbimit dhe riparimin e disa prej avionëve. Pas inspektimit, u vërtetua që në të dy kontratat, regjistruesit e prodhuar në Rusi ishin dorëzuar. Kërkohet ndihmë nga prodhuesi i pajisjes për të marrë informacionin nga pajisja. Një vendim se ku do të bëhet kjo do të merret gjatë bisedimeve. “Unë ju garantoj që nëse regjistruesi nxirret nga uji me informacionin në të, të gjitha veprimet e mëpasshme këtu në bazë do të ishin të tilla që këto informacione të ruheshin,” -tha Gjeneral Brigade Rusev. Në përgjigje të pyetjeve, komandanti i Bazës Ajrore Graf Ignatievo shpjegoi se gjatë fluturimit avioni operohej nga dy posta komanduese, një në Graf Ignatievo dhe një në zonën e vendit të provës. Të gjitha bisedat në radio u regjistruan, vulosën dhe iu dorëzuan komisionit hetimor menjëherë pas rrëzimit. Faktet e vërtetuara deri më tani janë se shënjestra ishte nisur në lartësinë e saktë prej 7,000 metrash.



ZLLATKO BLAZHEVSKI

# Muzetë ushtarakë të Forcave të Armatosura Gjermane

Gjermania ka disa muze ushtarakë dhe fortesa ushtarake të cilat dëshmojnë historinë, por pa dyshim që dy muzetë më të mëdhenj dhe më të vizituar janë: Muzeu i Forcave Ajrore në Berlin dhe Muzeu i Historisë Ushtarake në Dr-ezden. Dy muzetë në fjalë janë pjesë e sektorit të muzeve ushtarakë të forcave të armatosura gjermane, të cilët janë pjesë e strukturës së forcave të armatosura të Gjermanisë. Muzeu i Historisë Ushtarake fillimet e tij i ka që nga viti 1897, kur për herë të parë objekti është përdorur si vend për mbajtjen e armatimit dhe muze i armatës mbretërore saksone. Gjatë periudhës nga viti 1897 deri në vitin 1989 muzeu është riemëruar disa herë. Në vitin 1938, është riemëruar në Muze Ushtarak Nazist, ndërsa nga viti 1972 deri në vitin 1989 është përdorur emri Muzeu Ushtarak i Gjermanisë Lindore. Në vitin 1989 pas bashkimit të Gjermanisë Lindore dhe Gjermanisë Perëndimore, muzeu në fjalë është mbyllur me qëllim që të hetohet se si ky muze do të mund t'i përshtatet situatës së sapokrijuar në shtet. Pas restaurimit gjashtë vjeçar, në vitin 2011, muzeu përsëri është lëshuar në përdorim dhe shndërrohet në muze qendror i forcave të armatosura të Gjermanisë.

Muzeu posedon një sipërfaqe prej 14.000 metra katrorë në kuadër të muzeut janë edhe 20.000 metra katrorë shtesë, sipërfaqe të ekspozimit të jashtëm, gjë që këtë muze e bën të jetë njëherësh edhe muzeu më i madh në Gjermani. Vetë muzeu është përqendruar në dy aspekte, njëri është aspekti njerëzor kah lufta, ku nuk glorifikohet lufta apo armatat por prezantohen shkaqet dhe pasojat e luftës. Aspekti i dytë ka të bëjë me zhvillimin teknologjik të teknologjisë ushtarake gjermane, të prezantuar përmes një sërë ekspozitave. Muzeu specifikën e tij e thekson që para hyrjes në të. Ndërtimi i tij ka të bëjë me bashkëkohoren dhe të renë dhe me të vjetrën dhe klasiken. Dizajni i pjesës së jashtme të muzeut është pjesë e arkitektit polako-amerikan Daniel Libeskind, i cili për këtë vepër të tij është shpërblyer me dy shpërblime të larta të arkitekturës. Vetë shëtitja nëpër muze mund të realizohet përmes tërësive tematike dhe me renditje kronologjike. Muzeu ofron 11 ture tematike dhe tre tërësi kronologjike ndër vite 1300- 1914, 1914-1945 dhe nga viti 1945 deri më sot. Turet tematike të cilat janë të ekspozuara në muze janë: muzika dhe ushtria, ushtria dhe kujtimet, moda dhe ushtria, politika dhe përdorimi i forcës ushtarake, gjuha dhe ushtria, ushtria dhe loja, kafshët në kuadër të ushtrisë, ushtria dhe vuajtjet,



teknologjia dhe ushtria, mbrojtja dhe shkatërrimi.

Secila nga këto ture tematike në mënyrën e vet jep pikëpamje ndaj luftës dhe ndikimit të saj në jetën e përditshme. Pjesa e muzeut që i kushtohet aspektit të zhvillimit teknologjik të teknologjisë ushtarake gjermane është i ndarë në tre nën njësi, edhe atë të: armatimit dhe pajisjeve gabarite, pajisjeve dhe maketa dhe modele në distancë. Muzeu në fjalë posedon koleksion të rreth 7500 copëve të armëve të zjarrit, i cili përfshin pistoleta të kalibrit të ndryshëm, pushkë dhe mitralozë, nga të cilat gjysma e tyre janë që nga koha e Saksonisë, si dhe disa copë eksperimentale dhe unikalë të revolverëve dhe pistoletave të ndryshme. Ky koleksion është segmenti më i rëndësishëm i muzeut.

Përpos armëve të zjarrit, janë ekspozuar edhe armë të ftohta në të cilat përfshihen 1700 thika, 1100 bajoneta, si dhe rreth 800 lloje të ndryshme të armëve të ftohta shpuese. Uniformat të cilat janë të ekspozuara në këtë muze janë gjithashtu pjesë e ekspozimeve të shumta muzeore dhe paraqesin zhvillimin e armatës dhe aftësive të saj. Koleksioni në fjalë numëron rreth 70.000 palë uniforma të cilat datojnë që nga shekulli i XIX e deri në ditët e sotme. Përpos pjesëve të ekspozuara të uniformave, kemi edhe koleksione të mëdha të emblemave dhe shenjave të ushtrisë gjermane dhe të ushtrive aleate. Në kuadër të mjeteve

të ekspozuara muzeore janë edhe rreth 800 automjete, pjesa më e madhe e të cilave janë të ekspozuara në pjesën e jashtme të muzeut, ndërsa pjesa tjetër është e ekspozuar në brendinë e tij. Përpos këtyre ekspozitave në muze është i ekspozuar edhe një koleksion i madh i dokumenteve dhe fotografive, në mesin e të cilave edhe libri original

10.00 deri në ora 18.00. Duke e pasur parasysh madhësinë e muzeut dhe atë se çfarë ofron ai, nevojiten diku rreth 4 deri në 5 orë për ta parë atë në tërësi. Ky muze është sipas shumë gjërave shumë i pazakontë dhe ia vlen të vizitohet. Muzeu i Forcave Ajrore të Forcave të Armatosura Gjermane ndodhet në Berlin, në ish Aeroportin Luftwaffe dhe më vonë



me titull “Për luftën” i Klauzewitzit, etj. Bileta për hyrje në muze për personat e moshuar kushton 7 euro, për studentët dhe për pensionistët kushton gjithsej 3 euro. Për personat me invaliditet, për personat nën moshën 18 vjeçare dhe për ushtarakët hyrja është falas. Orari i punës së muzeut është çdo ditë nga ora

Forcën Ajrore Mbretërore, të njohur si Gatow. Ky muze është një degë e muzeve ushtarakë të Forcave të Armatosura Gjermane. Aeroporti në të cilën gjendet muzeu u ndërtua në vitin 1934 dhe u përdor fillimisht si një qendër trajnimit aviacioni për Rajhun e Tretë. Në prill të vitit 1945 u pushtua nga forcat ruse, por me ndarjen e Berlinit në lindje dhe perëndim, aeroporti ra në Mbretërinë e Bashkuar dhe RAF krijoi bazën e vet ajrore. Në vitin 1994, aeroporti iu dorëzua Forcave të Armatosura Gjermane, dhe që nga viti 1995, ai është përdorur si një muze ushtarak.

Muzeu i Forcave Ajrore daton që nga viti 1957, kur një koleksion avionësh dhe pajisjesh u mblodhën në Aeroportin Uetersen, pas së cilës u transferua në Gatow në 1995. Muzeu ka dy pista të shkurtra të përdorura për ekspozita të hapura dhe ngjarje të mëdha, ku një sipërfaqe prej rreth një milion metra katrorë ekspozon 60 deri në 70 aeroplanë, kryesisht nga periudha e Luftës së Ftohtë. Nga gjithsej nëntë hangarë në aeroport, kulla e kontrollit dhe dy hangarët përdoren për ekspozita, ndërsa njëra është menduar për restaurim dhe tre si depo. Hangarët e tjerë janë duke u rinovuar dhe ideja

është që të përdoren si një hapësirë ekspozite pasi të ketë përfunduar rinovimi. Muzeu, me ekspozitat e tij të përhershme, shpjegon zhvillimin e aviacionit gjerman, por gjithashtu adreson ndryshimet midis aviacionit lindor dhe perëndimor. Muzeu ka në koleksionin e tij rreth 160 aeroplanë, 5.000 uniforma dhe pajisje, një numër të madh dokumentesh dhe fotografish, sisteme kundërajrore dhe radarë, automjete ndihmëse të përdorura në aviacionin ushtarak, etj. Hangari nr. 3 strehon aeroplanë, helikopterë që përshkruajnë historinë e aviacionit gjerman nga 1884. Shumica e avionëve të vjetër të ekspozuar janë kopje të pjesëve origjinale të ngulitura. Avionët tipikë të ekspozuar në këtë hangar janë: “DFS 230”, “Farman III”, “Fokker D VII” (F), “Messerschmitt Me 163” dhe të tjerë. Përveç ekspozitave, ekzistojnë mbishkrime teksti me një përshkrim të shkurtër dhe karakteristikat e secilit avion të ekspozuar. Kulla e kontrollit është përdorur gjithashtu për një ekspozitë ekspozitash, me këtë pjesë të muzeut të dominuar nga dokumente, uniforma, shenja, fotografi dhe dy kabina avionësh, nga MiG-21 dhe F-4.

Vizitorët e muzeut mund të ngjiten nëpër shkallë dhe të shikojnë brenda këtyre dy avionëve. Hangari Nr. 7, me rreth 2.000 metra katrorë, ekspozon

zhvillimin e aviacionit gjerman gjatë Luftës së Ftohtë. Në të njëjtën kohë, në këtë hangar janë ekspozuar sisteme kundërajrore, helikopterë dhe aeroplanë nga aleanca e NATO-s, si dhe pajisje me origjinë perëndimore që është përdorur nga RDGJ. Disa nga avionët e ekspozuar në këtë seksion janë: “McDonnell Douglas F-4F Phantom II”, “Panavia Tornado IDS”, “Cessna T-37B”, “Mikoyan-Gurevich MiG-29G” dhe shumë të tjera. Në pjesën e jashtme të muzeut gjenden rreth 70 ekspozita që përmbajnë një numër të madh të avionëve nga periudha e Luftës së Ftohtë, disa sisteme luftarake kundërajrore, automjete ndihmëse, etj. Planet ideore janë që këto ekspozita të vendosen në hangarët e mbetur, sepse për shkak të ndikimit të jashtëm shumë prej ekspozitave janë në gjendje të keqe. Muzeu është i hapur çdo ditë nga e marta deri të dielën, duke filluar nga ora 10.00 deri në orën 18.00. Muzeu është i mbyllur gjatë festave zyrtare. Hyrja në muze është falas, pa pagese. Një nga avantazhet e këtij muzeu është aftësia për të parë lloje të ndryshme të avionëve me origjinë lindore dhe perëndimore dhe për të krahasuar zhvillimin e aviacionit.





## MODERNIZIMI I FORCAVE TË ARMATOSURA TURKE

# Raketa kombëtare, "Atmaca" do të fuqizojë Forcat Detare Turke

*Raketa "Atmaca" mund të përshkojë një distancë prej më shumë se 200 kilometrash*

Industria turke e mbrojtjes ka hedhur edhe një hap tjetër të rëndësishëm me raketën e prodhuar me mundësi vendore kundër-anije "Atmaca", për të siguruar nevojat e Forcave të Armatosura Turke me prodhime vendore dhe kombëtare.

Presidenti Recep Tayyip Erdogan tha se raketa e prodhuar me mundësi vendore, kundër-anija "Atmaca", në testin e fundit të kryer përpara se të hyjë në inventar, goditi plotësisht në shenjë anijen. "Raketa jonë kundër-anije "Atmaca", shpata jonë e çelikut e Atdheut tonë të Kaltër në testin e fundit të kryer përpara se të hyjë në inventar, goditi plotësisht në shenjë anijen. Urime për Forcat tona të Armatosura dhe Flotën tonë", -u shpreh Presidenti Erdogan në "Twitter", duke postuar gjithashtu një video nga testimi i raketës Atmaca.

"Atmaca", një raketë moderne e drejtuar që mund të përdoret në të gjitha kushtet atmosferike, është efektive kundrejt objektivave fikse dhe të lëvizshme falë rezistencës ndaj kundërmasave, azhurnimit të objektivit, aftësive të risulmimit dhe anulimit të misionit, si dhe sistemit të planifikimit të misionit të ardhshëm.

Industria turke e mbrojtjes ka hedhur edhe një hap tjetër të rëndësishëm me raketën e prodhuar me mundësi vendore, kundër-anijen "Atmaca",



për të siguruar nevojat e Forcave të Armatosura Turke me prodhime vendore dhe kombëtare. Raketa Atmaca u prodhua në mënyrë që të reduktojë varësinë e Turqisë nga burimet e

huaja, për të përmbushur nevojat e Komandës së Forcave Detare dhe për të zhvilluar një armë parandaluese me burime kombëtare. Raketa mund të përshkojë një distancë prej më shumë

se 200 kilometrash, duke paraqitur një kërcënim për objektivat larg pamjes vizuale dhe në testet e qitjes provoi se mund të arrijë në 250 kilometra. Deri më sot më shumë se 20 të shtëna janë

bërë me Atmaca, dhe përmirësimi i vazhdueshëm është arritur në testet e kryera që nga nëntori i vitit 2016. Shkalla e kualifikimit të linjës së prodhimit u bë me provën përfundimtare të testatës së luftës. Në përputhje me një skenar, nga korveta e anijes kombëtare "TCG Kınalıada" u bë testimi ndaj anijes "Isin", e cila ka dalë nga përdorimi. Testi u ndoq me shumë elementë në Qendrën e Testimeve në Sinop. Kontrata për prodhimin në seri të Atmacas u nënshkrua në 29 tetor 2018. Linja e prodhimit serik u kualifikua gjithashtu me provën në të cilën u përdor raketa numër 1, e cila u lëshua nga prodhimi masiv Kompania "Roketsan" do të sjellë raketat "Atmaca", të cilat janë jashtë prodhimit masiv në 2021, në anijet në inventarin e Forcave Detare Turke, veçanërisht "Milgem". Raketa numër 1 e dalë nga prodhimi serik kualifikoi gjithashtu linjën e serisë me provën në të cilën u përdor. Kompania "Roketsan" do të sjellë në inventarin e Forcave Detare Turke në anijet, veçanërisht "Milgem", raketat Atmaca, të cilat do të kalojnë në prodhimin masiv brenda vitit 2021.

## GJENERATA E PESTË E TURQISË

## Sateliti i komunikimit Turksat 5A i gatshëm për funksionim

Lançar nga kompania e teknologjisë SpaceX në janar, sateliti i gjeneratës së pestë të komunikimit të Turqisë, Turksat 5A është gati për shërbim në meridianin e 31-të lindor.

Turksat do të ofrojë shërbime të transmetimit televiziv në Evropë, Lindjen e Mesme dhe rajonin e Afrikës si dhe shërbime të komunikimit të dhënave në të gjithë zonën e mbulimit falë Turksat 5A, sipas të dhënave të përpiluara nga AA.

Së bashku me Turksat 5A, numri i satelitëve aktivë të komunikimit të Turqisë në hapësirë arriti në katër, Turksat 3A, Turksat 4A dhe Turksat 4B.

Sinjali i parë nga Turksat 5A u prapua 35 minuta pas lançimit me sukses në orbitë nga raketa Falcon 9 që u ngrit nga Bregu Lindor i SHBA-së.

Prodhuar nga Airbus me shtytje plotësisht elektrike, Turksat 5A udhëtoi për katër muaj në hapësirë për të arritur vendin e tij orbitor.

Pas përfundimit të testeve në orbitë, Turksat 5A filloi rrugëtimin e saj mbi 30 vjet të manovrimit ndërsa garantoj të drejtat e frekuencës dhe orbitës së Turqisë.

Sateliti do të sigurojë 1728 Mhz të kapacitetit Ku-Band mbi Turqinë,



Europën, Lindjen e Mesme, Afrikën e Veriut, Afrikën e Mesme, Afrikën e Jugut, Detin Mesdhe, Detin Egje dhe rajonin e Detit të Zi. Duke planifikuar zgjerimin e flotës së saj satelitore, zonat e mbulimit dhe kapacitetin, Turksat do

të lançojë satelitin 5B në hapësirë në tremujorin e katërt të këtij viti. Numri i satelitëve aktivë të Turqisë në orbitën e Tokës ka arritur në shtatë, përfshirë tre satelitë vëzhgues, Gokturk-1, Gokturk-2 dhe Rasat.

## Gazeta gjermane "Handelsblatt" dhe "Die Welt"

## Dronët "Bayraktar TB2" standard i ri i revolucionit në luftë

Dronët e armatosur vazhdojnë të jenë temë e nxehtë në Gjermani. Këtë herë gazeta "Handelsblatt" vlerësoi dronët dhe dronët e armatosur turq. Gazeta raportoi se dronët e armatosur turq kishin provuar veten në Siri, Libi dhe Karabak dhe bëri të ditur se "Ukraina dhe Polonia kanë blerë këta dronë, ndërsa shumë vende janë në radhë për t'i blerë". Ekspertët i përshkruan ato si "standard të ri të revolucionit në luftë". Drejtori Teknik i Kompanisë së Mbrojtjes "Baykar", Selçuk Bayraktar u vlerësua me lëvdën në raport duke thënë se "Sipërmarrësi 41-vjeçar turk e ka bërë vendin e tij më të mirë në luftërat e mundshme". Eksperti i Lindjes së Mesme Charles Lister përshkroi "dronët Bayraktar si standardi i ri i revolucionit në luftë të shekullit të 20-të, të ngjashëm me pushkën automatike ruse AK-47".

Aaron Stein, drejtor i Programit të Lindjes së Mesme në Institutin për Kërkime të Politikës së Jashtme, në një nga grupet e studimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), theksoi se Turqia po udhëheq përdorimin e dronëve në epokën e mediave sociale duke përhapur këto video. Stein kujtoi se përdorimi i dronëve në zonat e vëzhgimit, zbulimit dhe konfliktit nuk është i ri. "Megjithatë, Turqia e ka çuar këtë në një nivel të ri dhe ka treguar se si vendet mund të arrijnë ndikime strategjike dhe të rrisin interesin ndërkombëtar në shitjet e armëve", -bëri të ditur Stein.

Kurse Gazeta "Die Welt" u fokusua tek dronët e armatosur turq përmes një artikulli të titulluar "Si po bëhen trend në eksporte dronët luftarakë efektive turq?". Në këtë artikull u theksua se Polonia, një anëtare e NATO-s, ka porositur 24 mjete ajrore luftarake pa pilot të prodhuar nga Turqia. Pasi vuri në pah se dronët luftarakë turq janë të pajisur me teknologji të lartë, ditorja gjermane komentoi se "Turqia po zë vendin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Izraelit". "Die Welt" nënvizoi edhe se çdo ditë e më shumë vende duan të blejnë "Bayraktar TB2".







## **GARNIZONI I FLOTILJES DETARE PASHALIMAN**

# **Përfundon stërvitja fushore-ujore “Pashalimani 21”**

Batalioni i Forcave Speciale i dislokuar në garnizonin e Flotiljes Detare Pashaliman, ka zhvilluar stërvitjen fushore-ujore “Pashalimani 21”. Qëllimi i kësaj stërvitje ishte rritja e kushteve fizike të personelit, përvetësimi i teknikave të notimit, i teknikave për kalimin e pengesave ujore, si dhe aftësimi i përdorimit të mjeteve lundruese me dhe pa motor në interes të përballimit të emergjencave civile. Stërvitja “Pashalimani 21” ishte një nga stërvitjet fushore-ujore, e cila vijon të kryhet dhe nga repartet e tjera të Forcës Tokësore.

